

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Blerje materiale pastrimi ambjenti**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39831200-8 - Detergjentë

VLERA E FONDIT LIMIT: **6,162,436**(Gjashtëmilion e njëqind e gjashtedhjetë e dymije e katerqind e tridhjetë e gjashtë) **lekë pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike**, Shkoder ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- 1. *Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 9).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2022, 2023 dhe 2024) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku

vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës e përkatësisht **2,464,974** (dy milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, e cila paashikon se Autoriteti koonraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Konraktor.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024, duke përfshirë këtu edhe kestet e maturuara për vitin 2025.

Argumentimi: Janë kërkuar këto kritere në përputhje me nenin 77, pika 5 të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit në një vlerë prej **1 232 487 (njemiljone e dyqinde e tridhjetë e dy mijë e katerqinde e tetëdhjetë e shtatë) lekë**, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për shitjen e detergjenteve si dhe të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar (emër, e-mail). Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmimeve nga prodhuesi për pajisjet/artikujt e ofruara, e cila është vendosur në përputhje me Specifikimet Teknike të procedurës, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve

ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë e artikujve dhe nevojës për garanci mbi eficientësinë dhe kapacitetet teknike të pajisjeve/ artikujve.

2.3.3 Operatori Ekonomik Ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme (objekti i të cilave të jetë në përputhje me objektin e prokurimit), si me poshtë:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë”,
Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”

Argument: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e Autoritetit kontraktor të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatorpjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatornëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së .

Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave të tilla si certifikata ISO e cila është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogjet duke evidentuar produktin dhe skedat teknike (MSDS-te) te detergjenteve ku te dallohet qarte perputhja e te gjitha specifikimeve teknike te kerkuara me produktet e ofruara. Katalogjet duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe..

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të materialeve me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për materialet që propozon/oferton

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqese oferten teknike vetem per detergjentet që gjenden në shtojcen 7, në formë table, ku te plotesohet: Emri i kompanise prodhuese, Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga manuali i prodhuesit, linku i produktit ne web-in e prodhuesit si dhe çertifikimet perkatese per secilin produkt.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të materialeve me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për materialet që propozon/oferton si dhe natyres se mallrave objekt furnizimi qe do realizohen. Është kërkuar plotësimim i ofertës teknike nga ofertuesit pasi kërkohet që ata të deklarojnë në mënyrë specifike se ku e kanë marrë mallin që propozojnë të sjellin si dhe referencat se ku është i paraqitur në katalog.

2.3.6 Për Klorin lëng (Hipoklorit Natriumi) duhet te paraqese Raport Analize nga ISHP (Instituti i Shendetit Publik) ose institucione te tjera te akredituara .

Argumentim: Ky kriter është vendosur bazuar ne Urdherin nr.2 date 23.05.2014 te Ministrise se Shendetesise “Per autorizimin e importit te produkteve biocide dhe miratimin e listes se produkteve biocide per dezinfektim, deratizim dhe dezinfektim në shendet publik dhe produkteve per trajtimin e ujit te pijshem te lejuara per tregtim dhe perdorim ne Republiken e Shqiperise”

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim:*Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në

përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.